REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1896/8 *Prot.* *Tiranë, më* 31.07.2026

VENDIM

NR. 82 **, DATË** 31.7 **.2026**

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË DHË TË DREJTIMEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË FAKULTETIN E MJEKËSISË DENTARE, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 3 e në vijim, Vendimit nr.112, datë23.02.2018 *"Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"* të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar; Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 5, neni 12, neni 88, neni 89; Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 69, neni 70; Rregullores "*Për organizimin e programeve të Studimit të Doktoratave*", e përditësuar, dhe bazuar në propozimin e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, me shkresat nr. 375/13 prot., datë 24.06.2026 dhe nr. 375/20 prot., datë 09.07.2026, në mbledhjen e datës 31.07.2026 Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit (të përgjithshme dhe preferenciale), si dhe drejtimet e kërkimit shkencor për programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë në Mjekësi Dentare" me nënfusha: "Shkenca Dentare"; "Teknologji Dentare dhe Ortodonci"; "Kirurgji Oromaksilofaciale", sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë i përcillet Fakultetit të Mjekësisë Dentare të UMT-së.

KRYETARI

Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI

Aneksi nr. 1: Drejtimet e kërkimit shkencor dhe kriteret e pranimit në programin e ciklit të tretë të studimit Doktoratë me nënfusha, viti akademik 2026-2027, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT.

1. Doktoratë në Mjekësi Dentare me nënfusha:

1.1 Kirurgji Oromaksilofaciale

Drejtimi i kërkimit shkencor:

1. Patologji orale dhe maksilofaciale
2. Defektet e lindura OMF
3. Implantologji Dentare
4. Traumatologji OMF
5. Onkologjia OMF
6. Onkologji dhe rikonstruksion OMF

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e Stomatologjisë si dhe të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të barasvlershme, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht);
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të dytë mbi 8.
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat kërkimore të përcaktuara nga njësia bazë;
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
   - Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
6. Të ketë dy rekomandime me vlerësime pozitive nga persona, që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
7. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
8. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
9. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale:

1. Preferohet të punojë në fushën Stomatologjisë. Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UMT-së.
2. Preferohet të ketë përfunduar specializim afatgjatë në fushën e Kirurgjisë OMF.
3. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën e Kirurgjisë OMF.
4. Preferohet të kete marre pjese ne aktivitete shkencore si dhe te kete botime ne fushen e Kirurgjisë OMF.
5. Të jetë pjesë e një projekti kërkimor shkencor.

1.2 Shkenca Dentare

Drejtimi i kërkimit shkencor:

- Endodonti e avancuar

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e Stomatologjisë dhe të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të barasvlershme, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht);
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të dytë mbi 8.
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat kërkimore të përcaktuara nga njësia bazë;
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
6. Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
7. Të ketë dy rekomandime me vlerësime pozitive nga persona që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
8. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
9. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
10. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale

1. Preferohet të punojë në fushën e Stomatologjisë. Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UMT-së
2. Preferohet të ketë përfunduar specializim afatgjatë në fushën e Terapisë Stomatologjike.
3. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën e Terapisë Stomatologjike.
4. Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në fushën e Terapisë Stomatologjike.
5. Të jetë pjesë e një projekti kërkimor shkencor.

1.3 Teknologji Dentare dhe Ortodonci

Drejtimi i kërkimit shkencor:

1. Protetikë Dentare dhe implantare
2. Perio-Protetikë

Kriteret e përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e Stomatologjisë dhe të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të barasvlershme, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
2. Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht);
3. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të dytë mbi 8.
4. Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat kërkimore të përcaktuara nga njësia bazë;
5. Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:

6. Të menduarin krijues;
   - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
   - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
   - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
   - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit dhe ideve të reja.
7. Të ketë dy rekomandime me vlerësime pozitive nga persona që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
8. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
9. Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
10. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

Kriteret preferenciale:

1. Preferohet të punojë në fushën e Stomatologjisë. Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UMT-së.
2. Preferohet të ketë përfunduar specializim afatgjatë në fushën e protetikës.
3. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën e protetikës.
4. Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në fushën e protetikës.
5. Të jetë pjesë e një projekti kërkimor shkencor aktiv (në faze aktive).